



SHTESË PRINDËRORE PËR FËMIJËN E TRETË

Analiza e kostove dhe përfitimeve për masën sociale "Shtesë prindërore për fëmijën e tretë"



Stërvitje:

Autorë

Katerina Jakimovska - Instituti ZIP

Fexhri Selami - Instituti ZIP

Suada Statovci - Consulting për Zhvillim Strategjik

Mentorë

Dimitar Nikolovski - Fakulteti Ekonomik, Prilep

Përktheu

Nevrije Shabani

HYRJE

Vendet evropiane të cilat janë në fazën post-tranzitore të zhvillimit të popullsisë, e cila karakterizohet me norma të ulëta të lindjeve dhe fertilitetit, politikat e popullsisë janë konceptuar dhe zbatuar si përgjigje ndaj situatës konkrete të pafavorshme demografike në fushën e shtimit natyror të popullsisë. Kjo gjendje ndodh si pasojë e faktorëve të shumtë ekonomik, social, shëndetësor, politik, socio-psikologjik dhe faktorë të tjerë thelbësorë, të cilët në disa vende dhe periudha të zhvillimit të tyre ndikuan në rënien e numrit të lindjeve si faktor parësor endogjen dhe dinamik për ndryshim natyror të popullsisë.

Në shumë vende evropiane zbatimi i politikës stimuluese të popullsisë në formën pronataliste tregon se reduktimi i mëtejshëm i natalitetit mund të nxitet përmes masave të caktuara pronataliste që tentojnë të motivojnë prindërit për rritjen e numrit të fëmijëve në përputhje me dëshirat dhe mundësitë e tyre. Në Republikën e Maqedonisë në vitin 2009 u adoptua masa specifike për të paguar shtesë prindërore për fëmijën e tretë, e cila është pjesë e politikave publike për të rritur rritjen natyrale të popullsisë, duke krijuar kushte për amësi dhe për kujdesin e fëmijëve si dhe zhvillimin e qëndrueshëm demografik.

Analiza e kostove dhe përfitimeve duhet të përcaktojë nëse përfitimet ekonomike dhe sociale të programit janë më të mëdha se kostot përkatëse, me të cilat pastaj do të vlerësohet ndikimi dhe arsyetueshmëria e zbatimit të mëtejshëm të masës.

Periudha që i nënshtrohet analizës së kostove dhe përfitimeve është ajo e 2009-2014, gjegjësisht që nga fillimi i zbatimit të politikës që ka për qëllim stimulimin financiar të rritjes së numrit të fëmijëve të tretë në familje. Duke përdorur metodën analitike u përpunuan informacione të plota statistikore për numrin e përdoruesve dhe strukturën e tyre demografike të cilat u siguruan nga Zyra Shtetërore e Statistikës dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale të Republikës së Maqedonisë. Të dhënat për numrin e të porsalindurve dhe numrit të fëmijëve të porsalindur të tretë para inaugurimit të shtesës prindërore për në vitin 2009 dhe vitet 2010-2015 kanë shërbyer si tregues me të cilët janë matur objektivat e vendosura të politikës si pasojë e mungesës së treguesve të përcaktuara nga vetë institucionet që zbatojnë politikën.


FAKTE PËR GJENDJEN AKTUALE DHE POLITIKËN

Lëvizja natyrore e popullsisë është gjithnjë e më shumë objekt i debatit në botë si një përcaktues i rëndësishëm në qëndrueshmërinë e zhvillimit demografik të vendit. Urbanizimi, lëvizshmëria në rritje dhe një plakja e popullsisë imponohen si ndryshime të mëdha demografike që sfidojnë zhvillimin e qëndrueshëm demografik në nivel kombëtar.

Gjithashtu, Republika e Maqedonisë nuk është lënë jashtë këtij trendi global dhe përballet me sfida serioze demografike të shkaktuara nga kushtet ekzistuese sociale dhe ekonomike. Në periudhën 2002 dhe 2009 normat vjetore të rritjes natyrale të popullsisë dhe fertilitetit janë reduktuar në mënyrë të vazhdueshme në kurriz të rritjes së pjesëmarrjes së të moshuarve në strukturën e totalit të popullsisë (shih grafikun 1 dhe 2).

Grafiku 1.


Norma e rritjes natyrale të popullsisë në RM, periudha 2002-2009.



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës të Republikës Maqedoni

Grafiku 2.

Koeficientet total të fertilitetit në RM për periudhën 2002-2009.



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës të Republikës Maqedoni

Krijimi i strategjisë afatgjate për t'u marrë me të ashtuquajturin "Murtaja e bardhë" efektuohet si një domosdoshmëri e politikës konkrete edhe pas vitit 2006. Strategjia Kombëtare për zhvillimin demografik të Republikës së Maqedonisë nga viti 2008 deri në vitin 2015 paraqitet si një "dokument kryesor që pasqyron fushat prioritare dhe objektivat në formësimin e politikës demografike" (Министерство за труд и социјална политика, 2007).

Si një objektivi specifik strategjik theksohet ngadalësimi i normës së reduktimit të popullsisë dhe krijimin e kushteve për zhvillim të qëndrueshëm demografik, e cila do të çojë në një rritje të shtimit natyror të popullsisë, duke krijuar kushte të përshtatshme për amësi dhe kujdes të fëmijëve. Në masat specifike për të inkurajuar lindjet dhe kujdesin për fëmijët përfshihen stimuj financiarë për fëmijë të dytë dhe të tretë për çiftet e martuara që vijnë nga rajone ku shkalla e fertilitetit është nën 2.1 lindje të gjalla për grua.

Program drejtpërdrejtë synon të inkurajojë numrin e fëmijëve të tretë, dhe kjo nënkupton edhe shkallën e përgjithshme të natalitetit (e shprehur si numri i lindjeve të gjalla për 1,000 banorë). Megjithatë, në mënyrë indirekte pritet që kjo të reflektojë edhe në një rritje të pjellorisë (si numri mesatar i fëmijëve në periudhën riprodhuese të një gruaje), dhe rritjes natyrore (dallimi në mes numrit të lindjeve dhe numrit të vdekjeve).

Kjo masë u prezantua si plotësim i Ligjit të sigurimeve shëndetësore të vitit 2008 (Службен весник на РМ бр. 25/2000). Paralelisht me te, si ndryshim dhe plotësim në Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve (Службен весник на РМ бр. 98/2000) dhe Ligji për mbrojtje sociale (Службен весник на РМ бр. 50/1997) u inkorporua edhe ndihma financiare në formë të shtesës prindërore për një fëmijë të dytë (deri në 5.000 denarë në muaj, ose 30 për qind të pagës mesatare në vend. Ndihmën financiare për fëmijët e dytë familjet duhej ta marrin çdo muaj për një periudhë prej nëntë muajsh), dhe për fëmijë të tretë (në vlerë prej 8.250 denarë në muaj, ose 50 për qind e pagës mesatare në Maqedoni). Me këtë u vendos që familjet të marrin ndihmë financiare për çdo muaj për 10 vjet), dhe për fëmijën e katërt (deri në 11,550 denarë në muaj, ose 70 për qind e pagës mesatare në Maqedoni, të cilën familjet duhej ta marrin çdo muaj për 15 vjet). Shtesa prindërore ishte paraparë që të paguhet nga 1 janar-i 2009 për nënat, ndërsa në situata të jashtëzakonshme për baballarët ose kujdestarët e fëmijëve të lindur dhe të gjallë pas datës së specifikuar dhe të cilët jetojnë të paktën tre vjet në komunën në të cilën shtimi natyror është nën 2.1 promil.

Gjykata Kushtetuese në vitin 2009 vendosi të shfuqizojë Nenin në lidhje me të drejtën e kompensimit për fëmijët nënat e të cilëve jetojnë në komunat në të cilat rritja natyrore e popullsisë është nën 2.1 lindje të gjalla për grua (Службен весник на РМ бр. 199/2008). Kjo për shkak të përplasjes se nenit me normat kushtetuese për ushtrim të barabartë të së drejtës së mbrojtjes sociale për të gjithë qytetarët. Si rezultat i kësaj, Ministria e Punës dhe Çështjeve sociale vendosi për zbatimin e masës me çka të drejtë të shtesës prindërore do të ushtronin nënat e fëmijëve të tretë dhe të katërt në në të gjithë vendin dhe në shumën e përcaktuar. Nga 12 prill 2010 bëhet shfuqizimi i shtesës

prindërore për fëmijët e katërt të porsalindur dhe mbetet në fuqi vetëm shtesa financiare për fëmijët e tretë.

Për të ushtruar të drejtën e shtesës prindërore për fëmijën e tretë është parakusht që nëna që të jetë shtetase e Republikës së Maqedonisë me vendbanim të përhershëm në vend në tri vitet e fundit para paraqitjes së kërkesës. E drejta për përfitim prindërore të nënës u takon nënave që direkt kujdesen për fëmijën për të cilin ka aplikuar dhe fëmijët e paralindur të të cilave më parë nuk kanë qenë të vendosur në një institucion për mbrojtje sociale, strehim familjar apo të dhënë për adoptim dhe se nuk është e privuar nga e drejta prindërore mbi fëmijët e lindur më parë. E drejta nuk mund të ushtrohet nëse nëna gjatë shtatzënisë nuk ka kryer kontrolle shëndetësore dhe kontrolle të specialistit i zgjedhur mjekësor në gjinekologji dhe obstetrikë. E drejta gjithashtu nuk mund të ushtrohet, ose nëse është fituar mund të humbet, nëse:

- Nuk janë kryer vaksinimet e detyrueshme të fëmijës në përputhje me ligjin
- Fëmija nuk është i regjistruar në shkollë dhe nuk ndjek mësimin e rregullt në shkollën fillore në përputhje me ligjin.

Kompensimi prindërore për fëmijën e tretë paguhet në bazë mujore për një periudhë prej dhjetë vjetësh, në një vlerë prej 8,048 denarë. Shuma përputhet me rritjen e çmimeve të konsumit për vitin paraprak të publikuar nga Zyra e Statistikave Shtetërore të Republikës së Maqedonisë në janar për vitin aktual dhe korrigjimi i fundit është bërë në vitin 2012 (8.362 denarë).

SHPENZIMET DHE PËRFITIMET NGA POLITIKA

Në thelb, politika e popullsisë që synon stimulimin e natalitetit është dëshmuar si investim i kushtueshëm, e cila jo gjithmonë ka prodhuar rezultate të dukshme në rritjen e normave të fertilitetit. Argumenti kryesor për këtë është fakti se vendet e industrializuara kanë tendencë për të ndjekur dy drejtime në politikë (Gauthier, 2007):

1. Braktisjen e shtesës financiare që i dedikohet reduktimit të varfërisë;
2. Theks më i madh për politikat që reduktojnë barrierat për të kombinuar përgjegjësitë e punës dhe familjes.

Megjithatë, përmirësimi i kushteve të jetesës në aspektin e shpenzimeve sociale, mundësitë e infrastrukturës për kujdesin dhe kujdesin e fëmijëve, mundësimi i kushteve për një ekuilibër midis përgjegjësisë të punës dhe atyre familjare etj, luajnë një rol inkurajues në marrjen e vendimeve në lidhje me planifikimin familjar. Analiza e kostove dhe përfitimeve nuk merr parasysh efektet psikologjike dhe sociale mbi politikën publike andaj vlerësimi i saktë i të gjitha kostove dhe përfitimeve nuk mund të japë një pasqyrim të qartë dhe cilësor të programit.

A Shpenzimet

Vetë inkorporimi i masës „shtesë prindërore për fëmijën e tretë“ është një barrë e drejtpërdrejtë mbi buxhetin e Republikës së Maqedonisë. Fondet disbursohen përmes Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe Qendrës për punë sociale. Që nga inkorporimi i masës në vitin 2009 deri në fund të vitit 2015 numri i përfituesve të shtesës për fëmijën e tretë u rrit nga 1,898 (2009) në një total prej 21,387 përdoruesve në 2015. Në përputhje me metodën për përcaktimin e shumës për pagesën e shtesës, kostoja totale e drejtpërdrejtë e transfereve sociale për fëmijët e tretë nga viti 2009 në nivel vjetor është rritur nga 183.301.248 denarë në 2.146.057.128 denarë. Këto të dhëna janë marrë nga llogaritja përmes kalkulatorit CBA (anglisht: cost-benefit analysis). Pritet që këto shuma të shënojnë rritje nga viti në vit paralelisht me rritjen e foshnjave të treta.

Si një kosto e drejtpërdrejtë e programit për fëmijët e tretë paraqitet edhe e drejta e pushimit të lehonisë për nënat që janë përfituese të saj. Informacioni në lidhje me numrin e nënave të cilat janë përfituese të ndihmës për fëmijën e tretë dhe të cilat kanë përdorur të drejtën e pushimit të lehonisë nuk është dorëzuar me kohë nga Fondi për sigurim shëndetësor i Republikës së Maqedonisë. Por, me ndihmën e të dhënave për numrin e përgjithshëm të lindjeve të gjalla, të dhënat për numrin e përqindjes së nënave që kanë përdorur të drejtën e lehonisë është marrë bërë një përlogaritje që 34 për qind e nënave të cilët janë shfrytëzues të shtesës prindërore për fëmijën e tretë ushtrojnë edhe të drejtën e pushimit të lehonisë.

Shpenzimet shtetërore prej 161,103,331 denarë në vitin 2009 janë rritur në 399,766,552 denarë në vitin 2015 vit me tendencë për tu rritur paralelisht me numrin e fëmijëve të tretë të porsalindur dhe punësimit të nënave si përdoruese të kësaj të drejte. Për shkak të mungesës së informacionit të saktë mbi shkallën e punësimit në mesin e nënave të cilat janë përfituese të ndihmës për fëmijën e tretë, duke përdorur të dhënat nga Entit Shtetëror i statistikës së Republikës së Maqedonisë arritëm deri te numri i përgjithshëm i kompensimit për pushimin e lehonisë në raport me numrin e përgjithshëm të foshnjave të lindura (2009-33%, 2010-33%, 2011-37%, 2012-36%, 2013-39%, 2014-44%).

Supozimi ynë është se përafërsisht proporcionin e njëjtë të punësuarve ka edhe tek nënat që kanë tre fëmijë, respektivisht 34 për qind. Ky vlerësim tregon se një e treta e grave / nënave që kanë vendosur që të kenë një fëmijë janë të papunë ose joaktive në tregun e punës. Arsyet për këtë fenomen nuk mund të zbulohen me saktësi, por në qoftë se marrim parasysh faktin që gratë e papuna dhe joaktive janë më pak të arsimuara se sa të punësuarat, nuk ka informacion të pamjaftueshëm për lidhjen e mundshme ndërmjet motivimit për të rritur fëmijën e tretë në këmbim të të ardhurave dhe pjesëmarrjes në tregun e punës. Duke pasur parasysh hendekun gjinor në aspekt të pagave në R. e Maqedonisë, e cila është 12.5 për qind (Petreski, et al. 2014), ndikimi i kësaj politike mbi barazinë gjinore mund të observohet në aspekt të zëvendësimit të të ardhurave mujore nga tregu i punës nga ana e nënës, si përfitues.

Duke marrë parasysh shifrat që tregojnë për jo aktivitetin e nënave që janë shfrytëzues të shtesës prindërore në tregun e punës, së bashku me shifrën aktuale të hendekut gjinor në paga, hapet pyetja për korrelacionin në mes politikës demografike që insiston të kontribuojë në rritjen e numrit të sapolindurve të tretë dhe politikës për barazinë gjinore dhe rritjen e përfshirjes së grave në ekonominë dhe shoqërinë maqedonase. Kjo pyetje është e vështirë të kuantifikohet dhe të hulumtohet me këtë lloj analize, por le hapësirë të gjerë për një vëzhgim më të thellë.

Sa u përket shpenzimeve materiale direkte, nga ky program rezultojnë edhe shpenzimet e fushatës së vazhdueshme të mediave në periudhën 2009-2015. Ajo është e ndarë në dy komponentë: TV dhe radio spote të financuara përmes Sekretariatit të përgjithshëm të Qeverisë dhe subvencionim shtetëror të këngëve për të nxitur vlerat e familjes dhe familjet me shumë fëmijë të alokuara për artistë veçmas për çdo vit nga Ministria e Kulturës (Службен весник на РМ бр. 119 / 2013). Nuk ka të dhëna zyrtare në dispozicion për shpenzimet që lidhen me fushatën dhe ende jemi në pritje të një përgjigjeje nga institucionet përkatëse, megjithatë kontratat për zbatimin e fushatës për të promovuar vlerat e familjes në vitin 2012 dhe 2013 arrijnë një shumë totale prej 32,743,271 denarë (Бирова за јавни набавки, 2012).

Në aspektin e shpenzimeve indirekte të cilat do të shfaqen në afat të gjatë, sigurisht, kostoja e mirëmbajtjes së fëmijëve pas vitit të dhjetë, kur edhe ndërpritet pagesa e shtesës prindërore si dhe deri në vitin e 18 të jetës së fëmijut të tretë. Efektet e para të këtyre shpenzimeve do të dalin nga viti 2019, kur brezi i parë fëmijëve të tretë me të drejtën për të ushtruar përfitim prindërore do të kenë mbushur 10 vjet. Si efekti i programit pritet rritje akumuluese për fëmijën e tretë, dhe me këtë edhe rritje e kostos për rritje të fëmijëve nga moshja 11 e tyre deri në 18-të, periudhë kjo kur të gjitha kostot duhet të përballohen nga prindërit.

Б Пërfitimet

Në analizën e politikës është e vështirë për të bërë kuantifikim konciz për shkak se ajo është një masë sociale dhe vlerësimi i saj vështirësohet nga mungesa e qëllimeve të përcaktuara qartë dhe rezultatet që do të mundësonin më të lehtë për të vlerësuar nëse qëllimi është arritur. Nuk është specifikuar as numri i fëmijëve të tretë që pritet të lindin dhe as nuk është vendosur kornizë ose së paku rritja e pritshme e normës së natalitetit dhe fertilitetit. Vendosja e treguesve të veçantë do të mundësonte monitorim sistematik të realizimit të objektivave në mënyrë të vazhdueshme. Ajo që është vendosur si një tregues demografik për monitorimin e Strategjisë për zhvillimin demografik janë normat specifike të lindjes sipas moshës së gruas, normat e vdekshmërisë sipas moshës, neto-migracionet, indeksi i plakjes, koeficienti i varësisë së moshës dhe mbështetja potenciale, por pa vendosur rezultate të pritshme në forme kuantitative që do të mundësonte vlerësim të efektit. Kjo analizë është bërë ex post duke përdorur si tregues vetëm rezultatet e arritura.

SHTESË PRINDËRORE PËR FËMIJËN E TRETË

Megjithatë, përfitimi i drejtpërdrejtë i programit është të rrisë shpenzimet e konsumatorit. Duke supozuar se prirja marginale për të shpenzuar në Republikën Maqedonia shkon nga 0.85 në 0.95, kjo do të thotë që, mesatarisht, 90 për qind e fondeve që paguhen nga kompensimi janë të destinuara për konsum personal. Llogaritur në aspektin e mjeteve totale për transfertat sociale në vit, konsumi personal i cili në vitin 2009 arriti në 164,971,123 denarë, i njëjti shënon një rritje të vazhdueshme dhe në vitin 2015 arrin në 1.931.451.415. I njëjti pritet që të rritet edhe më tej paralelisht me numrin e fëmijëve të tretë (shih tabelën 1) me çka automatikisht rritet edhe numri i përdoruesve të kësaj shtese financiare.

Tabela 1 Statistikat vitale për Republikën e Maqedonisë nga viti 2002 deri në vitin 2014


	Totali	I pari	I dyti	I treti	Nataliteti	Rritja natyrore	Shkalla e përgjithshme fertilitetit
2002	27.761	11.956	9.581	3.256	13,7	4,8	1,59
2003	27.011	11.621	9.563	3.129	13,3	4,4	1,54
2004	23.361	10.816	8.395	2.779	11,5	2,7	1,52
2005	22.482	10.092	8.360	2.702	11	2	1,46
2006	22.585	10.491	8.179	2.634	11,1	1,9	1,46
2007	22.688	10.813	8.072	2.549	11,1	1,5	1,46
2008	20.137	9.289	7.393	2.352	11,2	1,9	1,52
2009	20.792	9.177	7.788	2.634	11,5	2,3	1,48
2010	21.338	9.315	7.757	2.967	11,8	2,5	1,46
2011	20.119	9.059	7.222	2.837	11,1	1,6	1,51
2012	20.826	9.105	7.522	3.122	11,4	1,7	1,55
2013	20.513	8.701	7.603	3.178	11,2	1,5	1,52
2014	20.890	8.760	7.746	3.336	11,4	1,5	1,47

Burimi: Enti Shtetëror Statistikor i Maqedonisë

Nga tabela mund të shihet se numri i fëmijëve të tretë nga viti 2009 tregon një rritje të lehtë, por kjo nuk është vërejtur edhe në numrin e përgjithshëm të lindjeve të foshnjave. Së paku, te numri i përgjithshëm i foshnjave të lindura nga 2009 deri më sot mund të vërehet stabilizim i trendit rënës që filloi në vitet ,90 të shekullit të kaluar.


Për të llogaritur efektin e programit, trendi i fëmijëve të tretë te lidur në periudhën 2002 dhe 2008 janë ekstrapoluar për periudhën aq sa zgjatë programit. Efekti i programit është marrë si diferenca midis numrit aktual i fëmijëve të tretë dhe vlera e marrë nga ekstrapolimi linear i periudhës së mëparshme. Duke aplikuar një ekstrapolim linear nga të dhënat në periudhën para futjes së programit (2002-2008), ajo që mund të shihet është se mesatarisht, çdo vit numri i fëmijëve të tretë zvogëlohet për 143 (shih grafikun 3)

Figura 3.
ekstrapolim linear i numrit të fëmijëve të tretë (2002-2008)



Gjithashtu, stabilizim mund të vërehet në raport me moshën e varësisë (Age dependency ratio), e cila në afat të gjatë mund të ndikojë në zvogëlimin e kostos për pensionet.

Grafiku 4.
Koeficienti i varësisë së moshës



SHTESË PRINDËRORE PËR FËMIJËN E TRETË


Për të përcaktuar përfitimin e uljes së kostos së pensioneve për Fondin pensional-invalidor të Maqedonisë është përdorur raporti aktuarial në sistemin e pensioneve në Republikën e Maqedonisë (Фонд за пензиско и инвалидско осигурување на Македонија, 2011). Përfitimi është parë si diferencë midis përqindjeve bazë në raport me skenarin pesimist. Duke supozuar se fëmijët e tretë të porsalindur do të hyjnë në tregun e punës në 2028, e njëjta pritet të jetë viti referent për të ndjerë përfitimet në këtë fushë. Në raportin aktuarial të dhënat janë shprehur si përqindje BPB-së, por edhe si shuma absolute (në milionë denarë dhe euro). Supozimi ynë është se efekti i politikës ka një kontribut afatgjatë duke shmangur skenarin pesimist. Prandaj, uljen e kostove të pensioneve e llogarisim si diferencë midis skenarit bazë dhe pesimist.

Për shembull, e shprehur në përqindje për vitin 2030, sipas skenarit pesimist, këto kosto do të ishin 8.84 për qind, ndërsa, sipas skenarit bazë dhe 8.56 për qind (diferenca është 0.28 për qind ose 2,024 milion denarë). Supozimi ynë është se vetëm një përqindje e caktuar e fëmijëve të tretë hyjnë në tregun e punës (njëjtë si e gjithë popullata). Argumenti kryesor është që politika kontribuon në stabilizimin e normave të natalitetit me çka shmanget skenari negativ i paraparë nga raporti aktuarial i Fondit pensional të Republikës së Maqedonisë. Prandaj përfitimi këtu mund të vlerësohet si diferenca në uljen e kostos në mes të skenarit bazë dhe pesimist.

Rritja inkrementale e shkallës së natalitetit si rezultat i programit deri më tani është i papërfillshëm (2.3 promil në vitin 2009 dhe 2.5 promil për 1,000 banorë në kushte kur paguhej shtesës prindërore për fëmijën e dytë dhe fëmijën e katërt, me një rënie

Grafiku 5.

Numri i fëmijëve të tretë, norma natyrore e rritjes së popullsisë dhe shkalla e fertilitetit



të shpejtë në vitin 2011 për 1.6 promil dhe një nivel i ngjashëm me vitin 2014 me 1.5 promil për 1,000 banorë) dhe mu për këtë arsye në term afatgjatë mbetet 0. E njëjta gjë vlen edhe për rritjen e PBB. Efekti i programit, i cili inicion një rritje të vazhdueshme të numrit të fëmijëve të tretë nga viti në vit është e qartë, por deri tani rritja është i papërfillshëm dhe për këtë arsye rritja e GDP mbetet 0. Në kushtet e kapitalit njerëzor, krijimi i zhvillimit të qëndrueshëm demografik është sigurisht përfitim për çdo shtet. Dinamika e lëvizjeve të popullsisë është thelbi i planifikimit strategjik dhe zhvillimit të politikave dhe në përgjithësi për kapitalin social dhe ekonomik të vendit.

REZULTATET E ANALIZËS SË PËRFITIMEVE DHE SHPENZIMEVE

Periudha relativisht e shkurtër në të cilën masa është në fuqi nuk mund të ofrojë një vlerësim të saktë të efekteve në afat të gjatë. Efekti i rritjes së numrit të fëmijëve të tretë lidhur me numrin e përfituesve të shtesës prindërore për fëmijën e tretë është re-vokuar nga niveli i ulët i rritjes natyrore, andaj efekti afatgjatë i stabilitetit demografik aktualisht është i papërfillshëm.

Tabela 2. Numri i përfituesve të shtesës prindërore për fëmijën e tretë në vitet:

2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015 nëntor
1.898	5.256	8.249	11.212	13.795	17.112	20.581

Burimi: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale

Në bazë të analizës së ndjeshmërisë, arritëm të simulojnë tre skenarë të mundshëm për efektin e „shtesës prindërore për fëmijën e tretë.” Analiza e ndjeshmërisë është bërë në aspektin e përfitimeve indirekte që janë më pak reale shkaku që këto parashihen në afat të gjatë. Më konkretisht, këtu përfshihen: rritja e BPB dhe kostot e reduktuara në fondin e pensioneve. Për shkak se programi ka efekte demografike, të cilat, sipas karakterit të tyre janë afat-gjate, kohëzgjatja është zgjatur për 30 vjet. Me qëllim të izolimit të efektit të programit, kosto indirekte dhe përfitimet çdo vit llogariten në drejtim të rritjes së numrit të.

A Skenari Bazë

Supozimi 1: Programi ka efekt në rritjen e BPB-së duke filluar nga 2033. Shuma e rritjes së BPB-së çdo vit pasardhës është rritja kumulative e fëmijëve të tretë të porsalindur 24 vjet më parë. Ne supozojmë se çdo vit 50 për qind e rritjes së fëmijëve të tretë të porsalindur para moshës 24 hyjnë në tregun e punës.

Supozimi 2: Shpenzimet e fondeve pensionale fillojnë të zvogëlohen nga viti 2028 në shumën e diferencës midis skenarit pesimist dhe atij bazë nga raporti aktuarial i fondit pensional. Kjo rrjedh nga fakti se programi kontribuon për të stabilizuar shkallën e natalitetit, p.sh. ndalon trendin rënës.

Vlera aktuale neto: -197.029.752

B Skenari optimist

Supozimi 1: Programi ka një efekt në rritjen e BPB-së duke filluar nga 2033. Shuma e rritjes së BPB-së çdo vit pasues është rritja kumulative e numrit të fëmijëve të tretë 24 vjet më parë. Supozojmë se çdo vit 70 për qindëshi i fëmijëve të tretë të porsalindur para moshës 24 vjet punësohen.

Supozimi 2: Shpenzimet e fondeve pensionale kanë filluar të ulen nga 2028 në shumën e diferencës midis skenarit pesimist dhe atij bazë sipas raportit aktuarial të fondit pensional. Kjo rrjedh nga fakti se programi kontribuon për të stabilizuar normën e lindjeve, p.sh. ndalon prirjen rënëse.

Vlera aktuale neto: -12.572.262

C Skenari pesimist

Supozimi 1: Programi ka një efekt në rritjen e BPB-së duke filluar nga 2033. Shuma e rritjes së BPB-së çdo vit pasues është rritja kumulative në fëmijë të tretë të porsalindur 24 vjet më parë. Ne supozojmë se çdo vit 30 për qindëshi i fëmijëve të tretë të porsalindur punësohen para moshës 24 vjeçare.

Supozimi 2: Shpenzimet e fondeve pensionale kanë filluar të ulen nga 2028 në vlerë prej 75 për qind të diferencës midis skenarit pesimist dhe atij bazë sipas raportit aktuarial të fondit pensional. Gjegjësisht, pavarësisht stabilizimit të shkallës së natalitetit, megjithatë, për shkak të rritjes së jetëgjatësisë, shpenzimet e fondit të pensionit do të reduktohen me ritëm të ngadalshëm.

Vlera aktuale neto: -877.942.542

Në përgjithësi, analiza e kostove dhe përfitimeve, si dhe analiza shtesë e ndjeshmërisë tregon se programi ka një vlerë aktuale neto negative. Nevojitet rishqyrtim i programit dhe / ose redizajnim i tij në mënyrë që të arrihen objektivat.

REKOMANDIMET

Ajo që mbetet e paqartë janë arsyet për heqjen e shtesës financiare për fëmijën e dytë dhe të katërt, si dhe objektivi kryesor dhe rezultatet e pritshme të zbatimit të mëtejshëm të politikës. Duke pasur parasysh rritjen e vazhdueshme të numrit të fëmijëve të tretë barra në buxhet pritet të rritet me të njëjtin intensitet dhe mbetet pyetja nëse do të ishte e mundur që financiarisht të vazhdohet zbatimi i masës së përcaktuar në këto kushte. Rekomandimi ka të bëjë me ri-përcaktimin e target grupit dhe të punohet për të krijuar një program nxitës për lindje të fëmijëve të parë dhe të dytë, e cila nuk duhet domosdoshmërisht të paraqesë kompensim të drejtpërdrejtë financiar.

Përvojat nga vendet e tjera flasin se politikat për rritjen e fertilitetit duhet të jenë më të drejtuara drejt sigurimit të fleksibilitet më të madh në marrëveshjet e punës dhe për arritjen e mbështetjes më të gjerë shoqërore. Rekomandimet për veprime në të ardhmen nga ana e shtetit në këtë fushë kanë të bëjnë me politikën e përgjithshme demografike që do të përmirësojë kushtet e jetesës së popullsisë fertile dhe do të motivonte për të marrë vendime që synojnë zgjerimin e familjes. Këtu përfshihen:

- kushtet ekonomike për të rinjtë në përgjithësi (punësimi, standardi jetësor, problemet e strehimit dhe kështu me radhë.)
- kushtet për gratë në tregun e punës (orar pune i adaptueshëm, siguria e vendit të punës, punësueshmëria)
- kushtet infrastrukturore (më shumë kopshte dhe institucione për kujdes ndaj fëmijëve pas përfundimit të mësimit ditor).

Politika populiste në vetvete nuk mund të jetë e suksesshme në qoftë se nuk ka një mjedis të favorshëm dhe kushte (socio-ekonomike) për lindjen dhe kujdesin ndaj fëmijëve. Duke pasur parasysh mbulimin e ulët në mbarë vendin me qendra për qëndrim ditorë për fëmijët dhe kopshte, në Strategjinë kombëtare për zhvillim demografik, si një prej masave specifike theksohet edhe rritja e aktiviteteve për përmirësimin e infrastrukturës në këtë drejtim - ofertë kopshtesh dhe dhënia e licencave për hapjen e kopshteve brenda kapaciteteve të ndryshme (fabrika, kompani, etj).

Paketa e tërë e përfitimeve për të rinjtë do të kishte një efekt më të madh në vendimin e tyre për të braktisur idenë e emigrimit dhe përqendrim në vetë-realizim të tyre në vend, si dhe mbi planifikimin familjar. Megjithatë, vendimet individuale dhe mundësitë që drejtpërsëdrejti përkrijnë me ndryshimet demografike ndryshojnë dhe shteti duhet të kërkojë që të rrisë numrin e mundësive në vend që të përqëndrohet vetëm në një drejtim. Së fundi, struktura demografike mund të formohet dhe të ndryshohet me anë të politikave publike, e cila nuk duhet në asnjë mënyrë të jetë në konflikt me të drejtat themelore të njeriut.

KONKLUZA

Analiza e kostove dhe përfitimeve për të masën sociale të shtesës prindërore për fëmijën e tretë tregon rezultate që në thelb nuk ndryshojnë shumë nga vendet ku i njëjti model gjen përdorim. Analiza në të gjitha rastet tregon se shumica e masave të ndërhyrjes së shtetit në rritjen e shkallës së fertilitetit janë të shtrenjta dhe tregojnë një efekt të pjesshëm. Nëse efekti i politikës për shtesë prindërore për fëmijën e tretë shikohet në mënyrë të izoluar, atëherë nuk mund të presin luhatjet më të mëdha në nivele makro.

Ajo që është evidente në rastin e Maqedonisë është se numri i fëmijëve të tretë, i cili shënon rënie në mënyrë të vazhdueshme që nga viti 2002, ka pasur një tendencë të qëndrueshme në rritje që nga futja e masës dhe kjo mund të konsiderohet si një e arritur e kësaj mase. Pas vitit 2010, pjesëmarrja e numrit të fëmijëve të tretë tejkalon shifrën prej 3,000 në vit në numrin e përgjithshëm të lindjeve të gjalla. Nga të dhënat e marra nga Ministria e punës dhe politikës sociale, vërehet një rritje e dukshme nga viti në vit i numrit të përgjithshëm të përfituesve të shtesës prindërore për fëmijën e tretë: nga 1,898 në 2009 në 21.387 shfrytëzues të shtesës prindërore për fëmijën e tretë në vitin 2015.

Në të njëjtën kohë, në qoftë se ju bëhet një rishikim i shkallës së rritjes natyrore, rritja e së cilës është marrë direkt si një rezultat specifik në Strategjinë kombëtare për zhvillim demografik, atëherë ajo që mund të vërehet është se numri i fëmijëve të tretë ka ndikim minimal në normën e përgjithshme të rritjes natyrore të popullsisë, me përjashtim të viteve 2009 dhe 2010 (në këto dy vjet paguhej shtesë financiare edhe për fëmijën e dytë edhe për fëmijën e katërt). Nga viti 2011 deri në vitin 2014 norma e rritjes natyrore është më e vogël edhe se në vitin 2006, kur ajo ishte 1.9. Treguesit e këtillë tregojnë për faktin se efekti i masës nuk përkon me objektivin, domethënë numri i rritur i fëmijëve të tretë nuk është i mjaftueshëm për të kompensuar mungesën e fëmijëve të parë dhe të dytë në numrin e përgjithshëm të foshnjave të lindura.

Në përgjithësi, analiza e kostove dhe përfitimeve, dhe analizave shtesë e ndjeshmërisë tregon se programi ka një vlerë aktuale neto negative. Nevojitet një rishqyrtim i programin dhe / ose redizajnim i saj në mënyrë që të arrihen objektivat e vendosura.

Për shkak të ndjeshmërisë së masës e cilat drejtpërsëdrejti ndërhyjnë në sferën intime të qytetarëve siç është planifikimi familjar, kjo analizë nuk ka të bëjë me momentin cilësorë që heton shkaqet dhe motivet e çdo qytetari (nëna si përfituese) për vendimin për të lindur një fëmijë të tretë aq më pak të hetojë korpusin e gjerë të faktorëve që janë të rëndësishëm për zhvillimin demografik. Në të njëjtën kohë, pamundësia për të siguruar të dhëna të plota dhe periudha e shkurtër kohore nga nisja e zbatimit të kësaj mase nuk i shërbejnë qëllimit për hartim të një analizë të thellë të efekteve të plota (përfitime ose kosto) nga analiza. Analiza e kostove dhe përfitimeve nuk mund të vlerësojë përfitime jo materiale (morale) që janë rezultat i vendimeve politike.

BIBLIOGRAFIA

- [1] Биро за јавни набавки (2012) *Извештување за склучен договор за јавна набавка, број на оglas 20/2012.*
- [2] Министерство за труд и социјална политика на Република Македонија (2008) *Стратегија за демографски развој на Република Македонија 2008 – 2015.*
- [3] Службен весник на РМ бр.50/1997. *Закон за социјална заштита.*
- [4] Службен Весник на РМ бр.25/2000. *Закон за здравствено осигурување.*
- [5] Службен весник на РМ бр.98/2000. *Закон за заштита на децата.*
- [6] Службен весник на РМ бр. 199/2008. *Одлука на Уставен суд.*
- [7] Службен весник на РМ, бр. 119/2013. *Закон за поддршка на домашната музичка продукција.*
- [8] Фонд за пензиско и инвалидско осигурување на Република Македонија (2011) *Извештај за пензискиот систем во Република Македонија со актуарски проекции.*
- [9] Gauthier Anne H. (2007) The impact of family policies on fertility in industrialized countries: a review of the literature. *Population Research and Policy Review* 26.3, p. 323-346.
- [10] Petreski, M., Mojsoska Blazevski, N. and Petreski, B. (2014) Gender wage gap when women are highly inactive: Evidence from repeated imputations with Macedonian data. *Journal of Labor Research* 35(4), p. 393-411.